



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-094

PËR SHËRBIMET E SHOQËRISË INFORMATIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR SHËRBIMET E SHOQËRISË INFORMATIKE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Ky ligj përcakton dokumentacionin në formë elektronike juridikisht të barabartë me dokumentacionin tradicional të paraqitur në format të letrës, për të lehtësuar shërbimet elektronike që përfshijnë, por që nuk kufizohen në shitblerje që bëjnë konsumatorët nëpërmjet Internetit (eTregtia), shërbimet elektronike bankare dhe ato financiare (ePagesa), ofrimin e shërbimeve qeveritare (eQeverisja), blerjen në formë elektronike nga ndërmarrjet (eProkurimi) dhe aplikimin e nënshkrimit elektronik.

2. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i mundësive dhe rrethanave të favorshme për zhvillimin e tregtisë elektronike, përdorimin e transaksioneve elektronike dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik si nga Qeveria, bizneset por edhe qytetarët. Gjithashtu, ky ligj ka për qëllim edhe

zvogëlimin e problemeve potenciale të keqpërdorimeve gjatë transaksioneve elektronike si dhe adresimin e sigurisë së sistemeve informatike.

3. Ky ligj zbatohet për cilindo lloj informacioni dhënë në formën e mesazhit të të dhënave, përveç rasteve, si në vijim:

3.1. kontratat që krijojnë apo transferojnë të drejtat për pasurinë e patundshme, përveç së drejtave të qirasë;

3.2. kontratat që me ligj kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike ose të atyre profesionale që ushtrojnë autoritet publik;

3.3. kontratat për garancinë e dhënë dhe për sigurimet kolaterale dhënë nga personat që veprojnë për qëllime jashtë fushës së tyre tregtare, të biznesit ose profesionit;

3.4. kontratat që rregullohen me Ligjin familjar ose me Ligjin për trashëgiminë.

Neni 2 **Përkufizime**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Akreditimi vullnetar** - çdo leje, që përcakton të drejtat dhe detyrimet e veçanta për kushtet e shërbimeve të certifikimit të nënshkrimeve, që me kërkesë nga ofruesi i interesuar i shërbimeve të certifikimit do të jepet nga organi publik ose privat i ngarkuar me zhvillimin dhe mbikëqyrjen e pajtimit me të drejtat dhe detyrimet e tilla, aty ku ofruesit të shërbimeve të certifikimit nuk i është dhënë e drejta që të ushtroj të drejtat që burojnë nga leja gjer në pranimin e vendimit nga organi.

1.2. **Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit - (ART)** - organi i pavarur rregullator të themeluar sipas Ligjit të Telekomunikacionit, për të rregulluar dhe për t'u kujdesur për zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit në Kosovë.

1.3. **Autori i mesazhit të të dhënave** - personi nga i cili ose në emër të të cilit mesazhi i të dhënave është dërguar apo krijuar më përpara se të ruhet, nëse ka ndonjë, por që nuk përfshinë personin që vepron si ndërmjetës në lidhje me atë mesazh të të dhënave.

1.4. **Certifikatë** - vërtetimi elektronik, që lidh të dhënat kontrolluese të nënshkrimit me një person dhe konfirmon identitetin e atij personi.

1.5. **Certifikata e kualifikuar** - certifikata e lëshuar nga ofruesi i shërbimeve të certifikimit dhe që përmban:

1.5.1. një indikacion që certifikata është lëshuar si certifikatë e kualifikuar;

1.5.2. identifikimin e ofruesit të shërbimeve të certifikimit dhe Shtetit në të cilin është themeluar;

1.5.3. emrin e nënshkruesit ose një pseudonim, që do të identifikohet si i tillë;

1.5.4. dispozitën për një atribut specifik të nënshkruesit që do të përfshihet nëse është relevante, varësisht nga qëllimi për të cilën certifikata është caktuar;

1.5.5. të dhënat për verifikim të nënshkrimit që korrespondojnë me të dhënat për krijim të nënshkrimit nën kontrollin e nënshkruesit;

1.5.6. një indikacion për fillim dhe mbarim të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;

1.5.7. kodin e identitetit të certifikatës;

1.5.8. nënshkrimin e avancuar elektronik të lëshuar nga ofruesi i shërbimeve të certifikimit;

1.5.9. kufizimet për fushëveprimin e certifikatës, nëse aplikohen; dhe

1.5.10. kufizimet për vlerën e transaksioneve për të cilat certifikata mund të përdoret, nëse aplikohen.

1.6. **Komerciale** - të gjitha çështjet që rrjedhin nga raportet e natyrës komerciale qoftë ato të kontraktuara apo të pa kontraktuara. Raportet e natyrës komerciale përfshijnë por nuk kufizohen me transaksionet si vijon:

1.6.1. ndonjë transaksion tregtar për furnizim ose shkëmbim mallrash dhe shërbimesh;

1.6.2. marrëveshjet e shpërndarjes;

1.6.3. përfaqësimi komercial ose i agjencisë;

1.6.4. faktoring;

1.6.5. marrje-dhënie me qira;

1.6.6. punët e ndërtimit;

1.6.7. këshillimin;

1.6.8. inxhinierinë;

1.6.9. licencimin;

1.6.10. investimin;

1.6.11. financimin;

1.6.12. veprimet bankare;

1.6.13. sigurimin;

1.6.14. marrëveshjen e shfrytëzimit ose të koncesionit;

1.6.15. ndërmarrjen e përbashkët dhe format e tjera të bashkëpunimit industrial ose të biznesit;

1.6.16. transportin ajror, detar, hekurudhor dhe rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve.

1.7. **Kompjuteri** - çdo pajisje ose grup pajisjesh të ndërlidhura ose të ngjashme, nga të cilat një ose më tepër, kryen procesimin automatik të të dhënave kompjuterike në pajtim me programin.

1.8. **Komunikim** - çdo shkëmbim ose bartje informacioni ndërmjet numrave të caktuar të palëve nëpërmjet shërbimeve publike elektronike në dispozicion. Kjo nuk përfshin ndonjë informatë të bartur si pjesë e një shërbimi transmetues për publikun nëpërmjet një rrjeti të komunikimit elektronik përveç nëse informacioni ka të bëjë me palën, si klient, abonent, regjistruar të identifikueshëm ose shfrytëzuesin që merr informacionin.

1.9. **Konsumator** - shfrytëzuesi i regjistruar dhe ose atë që ka nënshkruar ndonjë marrëdhënie të caktuar me ofruesin e shërbimeve.

1.10. **Kontrata elektronike** - kontrata e bërë tërësisht ose pjesërisht me komunikim elektronik apo në formë elektronike.

1.11. **Kontrollor** - çdo person fizik ose juridik, autoritetin publik, agjencionin ose ndonjë entitet tjetër që si i vetëm ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.

1.12. **Lëshuesi** - çdo institucion publik bankar apo kreditues që lëshon kartelë pagese për shfrytëzim elektronik, apo për ndonjë prodhim apo shërbim.

1.13. **Marrësi i mesazhit të të dhënave** - personi që synohet dhe cilësohet si marrës i mesazhit të të dhënave nga autori i mesazhit, mirëpo nuk përfshin personin që vepron si ndërmjetësues në lidhje me mesazhin e të dhënave.

1.14. **Mesazhi i të dhënave** - informacioni i krijuar, dërguar, pranuar ose të ruajtur me mjete elektronike, optike ose të ngjashme, duke përfshirë, por jo i kufizuar në

shkëmbimin elektronik të të dhënave (SHEDH), postën elektronike, telegramet, teleksat apo telekopjet.

1.15. **Mjeteve elektronike (nëpërmjet)** - që shërbimi është dërguar fillimisht dhe pranuar në destinacionin e vet nëpërmjet pajisjes elektronike për përpunim (duke përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtja e të dhënave, dhe tërë transmetimi, bartja dhe pranimi me mjete me tela, me radio, me mjete optike ose me mjete të tjera elektromagnetike.

1.16. **Ministri** - Ministrin e Ministrisë përgjegjëse për fushën e Shërbimeve të Shoqërisë Informatike.

1.17. **Ministria** - Ministrinë përgjegjëse për fushën e Shërbimeve të Shoqërisë Informatike.

1.18. **Nënshkrimi elektronik** - të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëngjiten ose shoqërojnë logjikisht mesazhin e të dhënave, dhe që mund të përdoren për të identifikuar nënshkruesin në lidhje me mesazhin e të dhënave.

1.19. **Nënshkrimi elektronik i avancuar** - nënshkrimi elektronik që plotëson kërkesat si vijon:

1.19.1. është i lidhur ekskluzivisht me nënshkruesin;

1.19.2. është në gjendje të identifikoj nënshkruesin;

1.19.3. është krijuar me përdorimin e mjeteve që nënshkruesi mund ti mbaj vetëm nën kontrollin e tij; dhe

1.19.4. është i lidhur me të dhënat tek të cilat lidhet në atë mënyrë që çdo ndryshim i mëpasshëm i të dhënave është i dallueshëm.

1.20. **Nënshkruesi** - personi që mban të dhënat për krijimin e nënshkrimit dhe vepron qoftë në emër të vet apo në emër të personit që e përfaqëson.

1.21. **Ndërmjetësues** - në lidhje me ndonjë mesazh të veçantë të të dhënave nënkupton personin që në emër të ndonjë personi tjetër dërgon, merr ose ruan mesazhin e të dhënave ose siguron shërbime tjera që lidhen me atë mesazh të të dhënave.

1.22. **Interoperabiliteti** - gjendje me anë të së cilës kartelat e lëshuara në Kosovë ose çdo Vend Anëtar i BE dhe/ose që i përkasin sistemit të caktuar të kartelave mund të përdoren në vendet e tjera Anëtare të BE dhe/ose në rrjetat e instaluara nga sistemet e tjera. Kjo kërkon që kartelat dhe lexuesit e përdorur në sistemet e ndryshme duhet të jenë teknologjikisht në pajtueshmëri dhe sistemet e tilla duhet të jenë të hapura me anë të marrëveshjeve të reciprocitetit.

1.23. **Ofruesi i shërbimeve të certifikimit** - personi që lëshon certifikata ose ofron shërbime të tjera lidhur me nënshkrimin elektronik në përputhje me këtë ligj.

1.24. **Pala e besueshme** - personi që mund të veproj në bazë të një certifikate apo nënshkrimi elektronik.

1.25. **Pagesa elektronike** - çfarëdo transaksioni pagese të drejtpërdrejt ose me shtyrje afati i kryer me anë të mjeteve elektronike, përveç pagesave me çek me kartelë garancioni bankar dhe pagesat me kartelë që përdorin proceset mekanike (faturim me rrëshqitje).

1.26. **Pajisja për krijimin e nënshkrimit** - softuerin ose harduerin e konfiguruar që përdoret për të aplikuar të dhënat për krijimin e nënshkrimit.

1.27. **Pajisja për krijimin e nënshkrimit të sigurt** - pajisjen për krijimin e nënshkrimit që, me mënyra të përshtatshme teknike dhe procedurale, i plotëson kërkesat si vijon:

1.27.1. garanton që të dhënat për krijimin e nënshkrimit të përdorura për prodhimin e nënshkrimit mund të ndodhin praktikisht vetëm një herë, dhe që fshehtësia e tyre është garantuar në mënyrë të arsyeshme;

1.27.2. garanton që të dhënat për krijimin e nënshkrimit të përdorura për prodhimin e nënshkrimit nuk mund, në nivel të arsyeshëm të sigurisë, të nxirren dhe që nënshkrimi është i mbrojtur kundër falsifikimit duke përdor teknologjinë e mundshme aktuale;

1.27.3. garanton që të dhënat për krijimin e nënshkrimit të përdorura për prodhimin e nënshkrimit mund të mbrohen arsyeshëm nga nënshkruesi legjitim kundër përdorimit nga të tjerët;

1.27.4. pajisja për krijimin e nënshkrimit të sigurt nuk i ndryshon të dhënat që do të nënshkruhen ose parandalon të dhënat e tilla nga paraqitja tek nënshkruesi përpara procesit të nënshkrimit.

1.28. **Personi i autorizuar** - çdo person fizik ose juridik që ka të drejtë, i lejohet me ligj, të përdorë, menaxhojë, kontrollojë, testojë, kryejë hulumtime shkencore legjitime ose ndryshe të operojë një sistem informatik dhe i cili vepron në pajtim me atë të drejtë apo autorizim.

1.29. **Pëlqimi** - nga përdoruesi ose parapaguesi i korrespondon pëlqimit të subjektit të të dhënave sipas legjislacionit të BE-së.

1.30. **Pëlqimi i subjektit të të dhënave** - nënkupton çdo tregues (indikatorë) të kuptueshëm dhe specifik, i dhënë me vullnet të lirë, me të cilin subjekti i të dhënave bie dakord që marrëveshja për të dhënat personale të tij të procesohet.

1.31. **Përgjimi i të dhënave nga aspekti teknik** - qasje në të dhënat kompjuterike të transmetimeve jopublike të ose nga një sistem informatik.

1.32. **Posta elektronike** - çfarëdo mesazhi në formë teksti, zëri, tingulli ose imazhi, të dërguar me anë të rrjetit të komunikimit elektronik publik që si i tillë mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen e fundme të marrësit deri në momentin kur merret nga pranuesi-marrësi.

1.33. **Procesimi në lidhje me të dhënat personale** - çdo veprim ose një numër veprimesh që kryhen në të dhënat personale: të dhënat personale, qoftë me mjete automatike apo jo automatike, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose përmirësimi, korrigjimi, konsultimi, shfrytëzimi, emetimi i transmetuar, përhapja ose mundësia e vendosjes, radhitja, kombinimi, bllokimi, fshirja ose asgjësimi i të dhënave.

1.34. **Rrjeta e komunikimeve elektronike** - sistemet transmetuese dhe kur janë të zbatueshme, pajisjet për komutim ose rutinim dhe burimeve të tjera që lejojnë bartjen e sinjaleve me anë të telit, të radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetat satelitore, fikse (qark- dhe paket-komutimi, duke përfshirë internetin) dhe rrjetet mobile tokësore, sistemet e kabllave elektrike, deri në masën që ato janë të shfrytëzueshme për qëllim të transmetimit të sinjaleve të rrjeteve të përdorura për radio dhe transmetimet televizive, rrjetave e kabllave të televizionit, pavarësisht nga lloji i informatës që bartet.

1.35. **Sistemi informatik** - sistemin për krijimin, dërgimin, pranimin, ruajtjen ose edhe përpunimin e mesazheve të të dhënave.

1.36. **Shërbimet e shoqërisë informatike** - cilido shërbim që është ofruar në distancë, me mjete elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit, nëse shërbimi i tillë është ofruar për konsiderim ose jo, dhe për qëllime të këtij përkufizimi:

1.36.1. **Në distancë** - që shërbimi është ofruar pa qenë njëkohësisht prezent palët;

1.36.2. **Me mjete elektronike** - që shërbimi është dërguar fillimisht dhe pranuar në destinacionin e vet nëpërmjet pajisjes elektronike për përpunim (duke përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtje të të dhënave, dhe tërë transmetimi, bartja dhe pranimi me mjete me tela, me radio, me mjete optike ose me mjete të tjera elektromagnetike;

1.36.3. **Me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit** - që shërbimi është ofruar përmes transmetimit të të dhënave me kërkesë individuale.

1.37. **Shfrytëzuesi** - personi fizik i cili për shfrytëzimin e shërbimeve të shoqërisë informatike nuk ka nevojë ose nuk është i detyruar të bëjë çfarëdo regjistrimi paraprak.

1.38. **Shkëmbimi elektronik i të dhënave-SHEDH** - transferimi elektronik të informacionit nga kompjuteri në kompjuter duke shfrytëzuar standardet e pajtueshme për strukturimin e informacionit.

1.39. **Të dhënat për verifikimin e nënshkrimit** - të dhënat, siç janë kodet, ose çelësat kriptografik publik, që janë përdorur për qëllim të verifikimit të nënshkrimit elektronik.

1.40. **Tregtari në lidhje me pagesat elektronike** - personin fizik ose juridik që ofron produkte ose shërbime.

1.41. **Zotërues** - poseduesin e kartelës kreditore dhe debitore lidhur me pagesat elektronike.

1.42. **Shitja Inerciale** - praktikat jolegale të dërgimit të mallrave të pa kërkuara, e pasuar nga një faturë për çmimin e mallit.

Neni 3 Ndryshimi me Marrëveshje

1. Për palët e përfshira në gjenerimin, dërgimin, pranimin, ruajtjen apo procesimin e mesazhit të të dhënave, nëse nuk jepet ndryshe, atëherë dispozitat e Kreut II mund të ndryshojnë me marrëveshje.

2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk ka ndikim në ndonjë të drejtë që mund të ekzistoj, të ndryshoj me marrëveshje ndonjë rregull të këtij ligji që jepet në Kreun II.

KREU II ZBATIMI I KËRKESAVE LIGJORE PËR MESAZHET E TË DHËNAVE

Neni 4 Njohja ligjore e mesazheve të të dhënave

Informacionit nuk i mohohet efekti ligjor, vlefshmëria apo zbatueshmëria, vetëm sepse është në formë të mesazhit të të dhënave, apo vetëm sepse nuk është përfshirë por vetëm është referuar në mesazhin e të dhënave që ka krijuar atë pasojë ligjore.

Neni 5 Shkrimi

1. Nëse sipas ndonjë ligji në Kosovë personit i është kërkuar ose lejuar që të jep informacionin me shkrim, ajo kërkesë do të konsiderohet si e plotësuar nga personi nëse personi e jep informacionin nëpërmjet mesazhit të dhënave, me kusht që:

1.1. në kohën që informacioni është dhënë, është e arsyeshme që të pritët që informacioni do të jetë i gatshëm për qasje ashtu që të jetë i përdorshëm për referim pasues; dhe

1.2. nëse është kërkuar që informacioni ti jepet personit ose personit tjetër në emër të tij, dhe personi i parë i përmendur kërkon që informacioni ti jepet sipas kërkesave të veçanta të teknologjisë së informacionit nëpërmjet llojit të veçantë të mesazhit të dhënash, kjo kërkesë e personit të jetë e plotësuar; dhe

1.3. nëse është kërkuar që informacioni ti jepet personit, atëherë personit të cilit i është kërkuar ose lejuar që informacioni ti jepet, lejon që ti jepet informacioni nëpërmjet të mesazhit të dhënave; dhe

1.4. nëse është kërkuar që informacioni ti jepet personit ose personit tjetër në emër të tij, dhe personi i parë i përmendur kërkon që një veprim i veçantë të merret nëpërmjet verifikimit të informacionit që pranohet, kjo kërkesë e personit të jetë e plotësuar.

2. Për qëllime të këtij neni, dhënia e informacionit përfshinë, por nuk kufizohet në:

2.1. bërjen e aplikimit;

2.2. bërjen ose paraqitjen e ankesës;

2.3. dhënien, dërgimin ose shërbimin e lajmërimit;

2.4. paraqitjen e kthimit;

2.5. bërjen e kërkesës;

2.6. bërjen e deklaratës;

2.7. paraqitjen ose lëshimin e certifikatës;

2.8. paraqitjen e kundërshtimit; dhe

2.9. bërjen e fjalimit.

3. Për qëllime të këtij neni, kërkesa ose lejimi në lidhje me personin që të jep informacion do të zgjerohet dhe do të jetë njëlloj e zbatueshme tek kërkesa ose informacioni që është shpallur i

dërguar, regjistruar, paraqitur, shërbyer ose ndryshe transmetuar dhe përfshinë shprehje të ngjashme ose në lidhje me të.

Neni 6 Nënshkrimi

1. Nëse në ndonjë ligj në Kosovë kërkohet nënshkrimi i personit, kërkesa e tillë konsiderohet e plotësuar nëse nënshkrimi i tillë është një nënshkrim elektronik dhe nënshkrimi i tillë nuk do të mohoj efektshmërinë ligjore në bazë të asaj se ai është:

1.1. në formën elektronike; ose

1.2. jo i bazuar në certifikatë të kualifikuar; ose

1.3. jo i bazuar në certifikatë të kualifikuar të lëshuar nga ofruesi i akredituar i shërbimeve të certifikimit; ose

1.4. jo i krijuar me pajisje të sigurta për krijimin e nënshkrimit.

2. Nëse nënshkrimi elektronik është në formën e nënshkrimit elektronik të avancuar, që është i bazuar në certifikatë të kualifikuar dhe është krijuar me pajisje të sigurta për krijimin e nënshkrimit, ai do të konsiderohet si nënshkrim i nënshkruesit për të gjitha synimet dhe qëllimet e ligjit.

3. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet nëse kërkesa është në formë të një obligimi ose nëse ligji paraqet pasojat për mungesën e nënshkrimit.

Neni 7 Originali

1. Përveç nëse parashihet ndryshe në këtë ligj ose më ndonjë ligj tjetër, personit i kërkohet që të krijoj ose të mbaj dokumentin në formën e vet origjinale, atëherë një kërkesë e tillë është e plotësuar nga mesazhi i të dhënave nëse:

1.1. ekziston një siguri e besueshme për integritetin e dokumentit nga koha kur për herë të parë është gjeneruar në formën e vet përfundimtare si mesazh i të dhënave apo ndryshe;

1.2. në kohën që mesazhi i të dhënave ishte dërguar, ishte e arsyeshme që të pritët që informacioni që përmban dokumenti në formën elektronike do të jetë i lehtë për qasje ashtu që të jetë i përdorshëm për referim pasues;

1.3. nëse është kërkuar krijimi i dokumentit për një person, ose person tjetër në emër të tij dhe personi i parë i përmendur kërkon që dokumenti ti jepet sipas kërkesave të

veçanta të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet llojit të veçantë të mesazhit të dhënash, kjo kërkesë e personit është e plotësuar; dhe

1.4. nëse është kërkuar krijimi i dokumentit për një person, atëherë personit të cilit i është kërkuar ose lejuar që informacioni ti jepet, lejon që ti jepet informacioni nëpërmjet të mesazhit të dhënave, dhe

1.5. nëse është kërkuar që dokumenti ti jepet personit, ose personit tjetër në emër të tij, dhe personi i parë i përmendur kërkon që një veprim i veçantë të merret nëpërmjet verifikimit të dokumentit që pranohet, kjo kërkesë e personit është e plotësuar.

2. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet nëse kërkesa është në formë të obligimit ose nëse ligji paraqet pasoja për mosparaqitjen apo mos ruajtjen e mesazhit në formën e vet origjinale.

3. Për qëllimet e këtij neni, tërësia e informacionit që përmban dokumenti është ruajtur vetëm në informacionin që mbetet komplet dhe i pandryshuar, me përjashtim të:

3.1. shtimit të ndonjë miratimi; ose

3.2. ndonjë ndryshim që nuk do ta ndryshoj informacionin, që është i nevojshëm gjatë komunikimit normal, ruajtjes ose paraqitjes.

Neni 8

Ruajtja e mesazheve të të dhënave

1. Nëse në ndonjë ligj, personit i kërkohet që të regjistroj informacionin me shkrim, kjo kërkesë konsiderohet që është e plotësuar nëse personi regjistron informacionin në formën elektronike, me kusht që informacioni i tillë në formën elektronike është lehtë i arritshëm, ashtu që të mund të përdoret për referim pasues dhe të pajtohet me rregullat e tilla që mund të jepen.

2. Nëse në ndonjë ligj, personit i kërkohet që të ruaj për një periudhë të caktuar dokumentin që është në formë të letrës ose ndonjë substance ose materiali tjetër, kjo kërkesë konsiderohet që është e plotësuar nëse personi ruan dokumentin në formën elektronike gjatë asaj periudhe, nëse:

2.1. lidhur me të gjitha kushtet relevante në kohën e krijimit të dokumentit në formën elektronike, metoda e krijimit të dokumentit në formën elektronike ka dhënë një mjet të besueshëm të garantimit të mirëmbajtjes së integritetit të informacionit që e përmban ai dokument; dhe

2.2. në kohën e krijimit të dokumentit në formën elektronike, kjo ishte e arsyeshme që të pritët që informacioni që përmban dokumenti në formën elektronike do të jetë i arritshëm lehtë ashtu që të mund të përdoret për referim pasues; dhe

2.3. pajtohet me rregullat e tilla që mund të jepen.

3. Për qëllim të paragrafit 2. të këtij neni, integriteti i informacionit që përmban një dokument është ruajtur vetëm nëse informacioni ka mbetur komplet dhe i pandryshuar, i sigurt për:

3.1. shtimin e ndonjë miratimi; ose

3.2. ndonjë ndryshim që nuk e ndryshon informacionin, që është i nevojshëm gjatë komunikimit të zakonshëm, ruajtjes ose paraqitjes.

4. Nëse në ndonjë ligj, personit i kërkohet që të ruaj për një periudhë të kërkuar informacionin që ishte subjekt i një komunikimi elektronik, kjo kërkesë konsiderohet që është plotësuar nëse ai person e ruan, ose e bën që ta ruaj një person tjetër, në formën elektronike që:

4.1. në kohën e fillimit të ruajtjes së informacionit, kjo ishte arsyeshme që të pritet që informacioni do të jetë i arritshëm lehtë ashtu që të mund të përdoret për referim pasues;

4.2. lidhur me të gjitha kushtet relevante në kohën e fillimit të ruajtjes së informacionit, metoda e ruajtjes të informacionit në formën elektronike ka dhënë një mjet të besueshëm të garantimit të mirëmbajtjes së integritetit të informacionit që e përmban komunikimi elektronik; dhe

4.3. gjatë asaj periudhe ai person gjithashtu ruan, ose e bën që ta ruaj një person tjetër, në formën elektronike informacionin e tillë shtesë të fituar si të mjaftueshëm për të mundësuar identifikimin e:

4.3.1. origjinës së komunikimit elektronik;

4.3.2. destinacionit të komunikimit elektronik;

4.3.3. kohës kur komunikimi elektronik ishte dërguar;

4.3.4. kohës kur komunikimi elektronik ishte marr;

4.3.5. në kohën e fillimit të ruajtjes së informacionit shtesë të specifikuar në këtë nën-paragraf, kjo ishte e arsyeshme që të pritet që informacioni shtesë do të jetë i arritshëm lehtë ashtu që të mund të përdoret për referim pasues; dhe

4.3.6. pajtohet me rregullat e tilla që mund të jepen.

5. Për qëllim të paragrafit 4. të këtij neni, integriteti i informacionit që është subjekt i një komunikimi elektronik është ruajtur vetëm nëse informacioni mbetet komplet dhe i pandryshuar, i sigurt për:

5.1. shtimin e ndonjë miratimi; ose

5.2. ndonjë ndryshim që nuk e ndryshon informacionin, që ndodh në një komunikim të zakonshëm, ruajtje ose paraqitje.

Neni 9

Pranimi dhe pesha e dëshmisë së mesazheve të të dhënave

1. Në çdo procedurë ligjore nuk do të zbatohen rregullat për provat që mohojnë pranimin e mesazheve të të dhënave si provë:

1.1. vetëm sepse është mesazh i të dhënave; ose

1.2. sepse nuk është në formën origjinale, në rast se është prova më e mirë që mund të gjendet nga personi që po e paraqet.

2. Informacioni në formën e mesazhit të të dhënave duhet të vlerësohet si çdo provë. Në vlerësimin e peshës së mesazhit të dhënave si provë duhet t'i kushtohet kujdes besueshmërisë së mënyrës se si ai mesazh i të dhënave është krijuar, ruajtur ose komunikuar, mënyrës në të cilën është ruajtur tërësia e informacionit, mënyrës në të cilën është identifikuar dërguesi/krijuesi si edhe çdo faktor tjetër relevant.

Neni 10

Miratimi dhe efektshmëria

1. Ministri mund, aty ku është e nevojshme në kooperim me Ministrat e tjerë që kanë të bëjnë me çështjen, të bëjë rregulla që jepen për çdo çështje në lidhje me shërbimet e Shoqërisë Informatike për të dhënë efekt të plotë në dispozitat e këtij ligji dhe veçanërisht, por pa dëmtuar parimin e përgjithshëm të këtij ligji, rregullat e tilla mund të jepen për:

1.1. çdo ulje ose fletë kufizim në lidhje me çdo transaksion ndër-kufitar këtu kjo është e nevojshme për një nga arsyet në vijim:

1.1.1. politika publike, veçanërisht mbrojtjen e të miturve, ose lufta kundër çdo incidenti nga urrejtja mbi baza të racës, gjinisë, religjionit, etnicitetit, opinionit politik ose nacionalitetit;

1.1.2. mbrojtjen e shëndetit publik;

1.1.3. sigurinë publike;

1.1.4. mbrojtjen e konsumatorit;

1.2. të identifikuar:

- 1.2.1. transaksionet;
 - 1.2.2. kërkesat ose lejet për të dhënë informacionin në formën e shkruar;
 - 1.2.3. kërkesat ose lejet për të prodhuar dokumentet;
 - 1.2.4. kërkesat për të ruajtur informacionin, dokumentet dhe komunikimin;
 - 1.2.5. nënshkrimet;
- 1.3. ato që mund të jenë të liruara nga ndonjë dispozitë e këtij ligji;
- 1.4. kërkesa shtesë për përdorimin e nënshkrimeve në mesazhet e të dhënave në sektorin publik;
- 1.5. miratimin e organeve publike ose personave që veprojnë në emër të organeve publike që informacioni të iu jepet nëpërmjet mesazhit të të dhënave.
- 1.6. pajtimin me çdo detyrim ndërkombëtar të filluar nga Qeveria në lidhje me çdo aspekt të shërbimeve të shoqërisë informatike të rregulluar nga ose nën këtë ligj;
2. Ministri do të themeloj qendrën kompjuterike për reagim emergjent me qëllim të trajtimit të kërcënimeve në sistemet publike të komunikimit elektronik.

KREU III

KOMUNIKIMI I MESAZHEVE TË TË DHËNAVE

Neni 11

Vlefshmëria e kontratave elektronike

1. Kontratës elektronike nuk do t'i mohohet efekti ligjor, vlefshmëria ose detyrueshmëria vetëm në bazë të asaj se ajo është plotësisht ose pjesërisht në formë elektronike ose ka filluar plotësisht ose pjesërisht me mënyrën elektronike të komunikimit.
2. Për qëllime të çdo ligji në lidhje me kontratat, një ofertë, pranimi i ofertës dhe çdo komunikim relevant, duke përfshirë çdo amendamentim pasues, anulim ose revokim të ofertës, pranimi i kontratës mund, veç nëse ndryshe janë dakorduar nga palët kontraktuese, të komunikohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Neni 12

Atribuimi i mesazheve të të dhënave

1. Një mesazh i të dhënave është i autorit, nëse ai është dërguar nga autori i mesazhit.
2. Ndërmjet autorit dhe marrësit konsiderohet se mesazhi i të dhënave i takon autorit nëse është dërguar:
 - 2.1. nga personi që ka pasur autoritet të veprojë në emër të autorit në lidhje me mesazhin e të dhënave; ose
 - 2.2. nga sistemi informativ i programuar nga, ose i cili vepron automatikisht në emër të autorit.
3. Ndërmjet autorit dhe marrësit, marrësit i jepet e drejta të vlerësojë mesazhin e të dhënave se i takon autorit dhe të veprojë në atë supozim, nëse:
 - 3.1. marrësi ka zbatuar, siç duhet procedurën me pëlqimin më parë të autorit për qëllim të sigurohet nëse mesazhi i të dhënave ka qenë nga autori; ose
 - 3.2. mesazhi i të dhënave, si i pranuar nga marrësi, rezulton nga veprimet e personit, lidhshmëria e të cilit me autorin apo me ndonjë tjetër person- agjent i mundëson atij personi të ketë qasje në metodën e shfrytëzuar nga autori për të identifikuar mesazhin e të dhënave ashtu si të tij.
4. Paragrafi 3. i këtij neni nuk zbatohet:
 - 4.1. nga koha kur marrësi ka marrë njoftimin nga autori se mesazhi i të dhënave nuk është i autorit dhe ka pasur kohë të mjaftueshme për të vepruar në përputhje; ose
 - 4.2. në rastin në kuadër të nën-paragrafit 3.2. të paragrafit 3. të këtij neni, në çdo kohë, kur marrësi ka qenë në dijeni ose është dashur të dijë, ka shfaqur kujdes të arsyeshëm apo ka shfrytëzuar ndonjë procedurë të pajtuar, që mesazhi i të dhënave nuk i takon autorit.
5. Marrësi ka të drejtë, të konsiderojë të pranuar mesazhin e të dhënave, ashtu siç autori ka synuar të dërgojë, dhe të veprojë mbi atë supozim, nëse mesazhi i të dhënave është i autorit apo merret si i tij.
6. Marrësi nuk ka të drejtë sipas paragrafit 5. të këtij neni, kur ka qenë apo është dashur të jetë në dijeni, se transmetimi i mesazhit të pranuar për të dhënat, ka rezultuar me gabime.
7. Marrësi ka të drejtë të konsiderojë secilin mesazh të dhënave, ta marrë si mesazh të veçantë të dhënave dhe të veprojë mbi atë supozim, përveç në rastin kur i njëjti mesazh është përsëritur dhe marrësi ka qenë në dijeni apo është dashur ta dinte, i ka kushtuar kujdes të arsyeshëm ose e ka shfrytëzuar ndonjë procedurë të pajtuar, se mesazhi i të dhënave është i përsëritur.

Neni 13

Pranimi i konfirmimit

1. Kur autori nuk pajtohet me marrësin që konfirmimi në pranim të jepet në një formë të veçantë ose me një metodë të veçantë, atëherë konfirmimi i pranimit mund të jepet me:

1.1. ndonjë komunikim me marrësin, automatikisht ose në çfarëdo forme tjetër, apo

1.2. ndonjë veprim i marrësit i mjaftueshëm për t'i treguar autorit se mesazhi i të dhënave është pranuar.

2. Kur autori i mesazhit të të dhënave ka shprehur se mesazhi i të dhënave kushtëzohet me konfirmim të marrjes, atëherë mesazhi i të dhënave, përderisa nuk pranohet konfirmimi, trajtohet sikur të mos ishte dërguar.

3. Kur autori i mesazhit nuk ka deklaruar se mesazhi i të dhënave kushtëzohet me pranimin e konfirmuar të marrjes dhe ky konfirmim nuk është pranuar nga autori brenda kohës së specifikuar ose janë marrë vesh, apo nuk është specifikuar a pajtuar për kohën, ose brenda kohës së arsyeshme, atëherë autori:

3.1. mund ta njoftojë marrësin dhe i thotë se ai nuk ka marrë ndonjë konfirmim dhe specifikimin e kohës së arsyeshme, deri kur duhet të pranohet konfirmimi për pranimin e mesazhit të të dhënave; dhe

3.2. nëse pranimi nuk konfirmohet brenda kohës së specifikuar në nën-paragrafin 3.1. të këtij paragrafi në njoftim për marrësin mund ta trajtojë mesazhin e të dhënave sikur nuk është dërguar asnjëherë ose të ushtrojë ndonjë të drejtë që mund ta ketë.

4. Paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni zbatohet në kohën ose para dërgimit të mesazhit të të dhënave ose në kuptimin e atij mesazhi të të dhënave, autori ka kërkuar apo është pajtuar me marrësin që pranimi i mesazhit të të dhënave të jetë i konfirmuar.

5. Kur autori i mesazhit ta ketë marrë konfirmimin për pranimin e mesazhit nga marrësit, atëherë merret se mesazhi i të dhënave është pranuar nga ana e marrësit. Ky supozim nuk nënkupton se mesazhi i të dhënave korrespondon me mesazhin e pranuar.

6. Kur pranimi i konfirmimit tregon se mesazhi i të dhënave i plotësonte kërkesat teknike, qoftë të pajtuara ose të paraqitura në standardet aplikuese, supozohet se kërkesat janë plotësuar.

7. Përveç që ka të bëjë me dërgimin ose me pranimin e mesazhit të të dhënave, ky nen nuk ka për qëllim të merret me pasojat ligjore që mund të dalin qoftë nga ai mesazh i të dhënave apo nga pranimi i konfirmimit të tij.

Neni 14

Koha dhe vendi i dërgimit dhe i pranimit të mesazheve të të dhënave

1. Përveç nëse merren vesh ndryshe, autori dhe marrësi, dërgimi i mesazhit më të dhënat ndodh pasi të futet në sistemin e informatave, jashtë kontrollit të autorit, ose të personit i cili ka dërguar atë mesazh të të dhënave në emër të autorit.

2. Përveç nëse merren vesh ndryshe, autori dhe marrësi, koha e pranimit të mesazhit të të dhënave përcaktohet si vijon:

2.1. nëse marrësi ka caktuar sistemin e informatave për qëllimin e pranimit të mesazheve të të dhënave bëhet:

2.1.1. në kohën kur mesazhi i të dhënave futet në sistemin e caktuar informatik; ose

2.1.2. nëse mesazhi i të dhënave është dërguar në sistemin informatik të marrësit që nuk është sistem i caktuar informatik në kohën kur mesazhi i të dhënave është korrigjuar nga marrësi;

2.1.3. nëse marrësi nuk e ka caktuar sistemin informatik, pranimi bëhet kur mesazhi i të dhënave futet në sistemin informatik të marrësit.

3. Paragrafi 2. i këtij neni zbatohet pavarësisht nga vendi ku sistemi informatik është vendosur, mund të jetë i ndryshëm nga vendi ku mesazhi i të dhënave konsiderohet të jetë pranuar sipas paragrafit 4. të këtij neni.

4. Përveç nëse merren vesh ndryshe, autori dhe marrësi, mesazhi i të dhënave konsiderohet se është dërguar në vendin ku marrësi e ka vendosur biznesin. Për qëllimet e këtij paragrafi vlen:

4.1. nëse autori ose marrësi ka më shumë se një vend në të cilin e zhvillon biznesin, vendi i biznesit është ai që ka afërsi më të madhe me transaksionin e dhënë, kur nuk ekziston transaksioni i dhënë që është vendi kryesor i biznesit;

4.2. nëse autori ose marrësi, nuk kanë vend të biznesit, referimi duhet të bëhet në vendbanimin e tyre.

KREU IV THEMELIMI DHE KËRKESAT INFORMATIKE

Neni 15 Themelimi dhe autorizimi

1. Shërbimet e shoqërisë informatike janë të gjitha ato shërbime që zakonisht ofrohen me pagesë, në largësi me anë të mjeteve elektronike dhe me kërkesa individuale të shfrytëzuesit të shërbimit.

2. Ky ligj nuk do të zbatohet për:

2.1. shërbimet që nuk ofrohen "në distancë";

2.2. shërbimet e ofruara në praninë fizike të ofruesit dhe të marrësit, edhe në qoftë se ato përfshijnë përdorimin e pajisjeve elektronike:

2.2.1. ekzaminimet mjekësore ose tretmanët në ambulanca mjekësore, duke përdorur mjetet elektronike, ku pacienti është fizikisht i pranishëm;

2.2.2. konsultimet e një katalogu elektronik në një shitore në prani të klientit; rezervimi i biletave;

2.2.3. lojërat elektronike të qasshme video-arcade ku klienti vetëm fizikisht është i pranishëm.

2.3. për shërbimet që nuk ofrohen, me anë të mjeteve elektronike;

2.4. shërbimet që kanë përmbajtje materiale, edhe pse ofrohen nëpërmjet pajisjeve elektronike:

2.4.1. arkat automatike ose aparatet për furnizim me bileta (bankënota, bileta treni);

2.4.2. qasje në rrjetin rrugor, parkingjet etj, obligimet për shfrytëzim edhe nëse janë mjete elektronike në hyrje-dalje, të qasjes kontrolluese dhe/ose duke siguruar së pagesa ishte korrekte.

2.5. shërbimet e shkyçura, shpërndarja e CDROM-it ose e softuerëve në disketa;

2.6. shërbimet që nuk janë ofruar nëpërmjet procesimit elektronik, ose sistemit të tillë, duke përfshirë, por jo të limituar për:

2.6.1. shërbimet telefonike me zë;

2.6.2. telefaksit/telex dhe shërbimet e teleksit;

2.6.3. shërbimet e ofruara nëpërmjet telefonisë me zë apo faks;

2.6.4. konsultimi me doktorin me telefoni-faks;

2.6.5. konsultimit me avokatin me telefon-faks;

2.6.6. marketingu i drejtpërdrejtë telefon-telefaks.

2.7. për shërbimet që nuk kompletohen "me kërkesën individuale të marrësit të shërbimeve";

2.8. shërbimet e ofruara me transmetimin e të dhënave pa kërkesën individuale për pranimin në të njëjtën kohë nga një numër i pakufizuar i marrësit individual (për një pikë deri te shumë pika të transmetuara):

2.8.1. shërbimet e radiotransmetimit;

2.8.2. shërbimet transmetuese televizive;

2.8.3. teleteksti i ofruar nga transmetimet televizive;

2.8.4. të gjitha shërbimet e transmetimeve televizive të definuara nga Ligji përkatës për komunikime elektronike.

3. Ofrimi i shërbimeve të shoqërisë informatike nuk duhet të kërkojë autorizim paraprak ose çfarëdo kërkesë tjetër që ka efekt ekuivalent, me përjashtim të:

3.1. ofruesit e shërbimeve që shfrytëzojnë infrastrukturën e tyre duhet të marrin autorizime sipas Ligjit përkatës për komunikime elektronike;

3.2. ofruesit e shërbimeve financiare ose të sigurimit, sipas legjislacionit për ato shërbime.

Neni 16

Informacioni i përgjithshëm që duhet ta ofrojë ofruesi i shërbimit

1. Ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë qasje të përhershme të lehtë dhe direkte për pranuesit e shërbimit dhe për autoritetet kompetente për informatat në vijim:

1.1. emrin e ofruesit të shërbimit;

1.2. adresën e vendit- në të cilën është vendosur ofruesi i shërbimit;

1.3. detalet e ofruesit të shërbimit, duke përfshirë adresën e emailit dhe lokatorin universal regjistruar (URL) të ofruesit të shërbimit, që i lejohet atij që të kontaktohet shpesh dhe të komunikoj në mënyrë të drejtpërdrejt dhe efektive;

1.4. regjistrimin e biznesit, në të cilin ofruesi i shërbimit ka hyrë dhe numrin e tij të regjistrimit;

1.5. hollësitë e autoritetit relevant mbikëqyrës, në rastet kur aktiviteti është subjekt i një skeme autorizuese;

1.6. për profesionet e lidhura me tregtinë elektronike:

1.6.1. çfarëdo entiteti profesional ose institucion i ngjashëm me të cilin ofruesi i shërbimit është i regjistruar;

1.6.2. titulli profesional dhe autoriteti nga i cili është dhënë;

1.6.3. referencë për rregullat profesionale të zbatueshme në juridiksionin e ndërmarrjes dhe mjetet për të pasur qasje në to;

1.7. TVSH – numri identifikues i tatimit (nëse zbatohet).

2. Kur shërbimet e shoqërisë informatike u referohen çmimeve atëherë çmimet duhet të shënohen qartë, të tregojnë nëse ato përfshijnë edhe tatimet dhe koston e shpërndarjes.

KREU V KOMUNIKIMET KOMERCIALE

Neni 17 Informacioni që duhet të ofrohet

1. Komunikimet komerciale që janë pjesë e shërbimit të shoqërisë informatike, duhet të përputhen të paktën me kushtet e dhëna në vazhdim:

1.1. komunikimet komerciale si të tilla duhet të identifikohen qartë;

1.2. personi fizik ose juridik në emër të të cilit është bërë komunikimi komercial duhet të identifikohet qartë;

1.3. ofertat reklamuese (zbritjet e çmimeve, premitë dhe dhuratat) duhet të identifikohen qartë si të tilla, dhe kushtet që duhet plotësuar për tu kualifikuar për to, duhet të jenë lehtësisht të qasshme dhe të paraqitura dallueshëm dhe qartë;

1.4. garat ose lojërat reklamuese, të lejuara sipas ligjit aty ku është themeluar ofruesi i shërbimit, duhet të jenë qartë të identifikueshme si të tilla, dhe kushtet për pjesëmarrje duhet të jenë lehtësisht të qasshme dhe të paraqitura dallueshëm dhe qartë;

Neni 18

Komunikimet e padëshiruara komerciale

1. Komunikimet e padëshirueshme komerciale me postë elektronike janë të ndaluara përveç në rastet kur pranuesi e lejon një gjë të tilla paraprakisht.
2. Ofruesit e shërbimeve rregullisht duhet të konsultojnë dhe t'i respektojnë regjistrat në të cilët pranuesit që nuk dëshirojnë të pranojnë komunikime të tilla komerciale, mund të çregjistrohen.

Neni 19

Rregullat për profesionet

1. Shfrytëzimi i komunikimeve komerciale që janë pjesë e shërbimeve të shoqërisë informatike të ofruara nga profesionistët lejohen nëse ato ofrohen në përputhje me rregullat, dinjitetin dhe etikën profesionale, fshehtësinë profesionale, korrektësinë ndaj klientëve dhe anëtarëve tjerë profesional.
2. Entitetet profesionale dhe shoqatat nxiten të krijojnë kode të sjelljes që duhet të jenë plotësisht në përputhje me standardet evropiane dhe me ato ndërkombëtare.

KREU VI

KONTRATAT E BËRA NË MËNYRË ELEKTRONIKE

Neni 20

Informacioni që duhet të ofrohet

1. Informacioni në vazhdim duhet të jepet tërësisht i dallueshëm dhe i qartë nga ofruesi i shërbimit para se të bëhet porosia nga pranuesi i shërbimit, përveç nëse merren vesh ndryshe nga palët që nuk janë konsumatorë:
 - 1.1. hapat e ndryshëm teknik për përmbushjen e kontratës;
 - 1.2. kontrata, qoftë e përmbushur apo jo, duhet të arkivohet nga ofruesi i shërbimit, ashtu që të ketë qasje në të;

1.3. mjetet teknike për të identifikuar dhe për t'i përmirësuar gabimet e futura para se të bëhet porosia;

1.4. gjuhët e ofruara për lidhjen e kontratës.

2. Përveç kur palët që nuk janë konsumatorë arrijnë marrëveshje tjetër, ofruesi i shërbimit tregon kodin e sjelljes, në të cilat ai përshkruan dhe tregon se si mund të paraqiten këto kode në formën elektronike.

3. Dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni nuk zbatohen për kontratat e arritura ekskluzivisht nga shkëmbimi i postës elektronike ose i komunikimeve individuale.

4. Afatet e kontratës dhe kushtet e përgjithshme për pranuesin duhet të vihen në dispozicion në atë mënyrë që t'i lejohet atij t'i ruaj dhe t'i riprodhojë ato.

Neni 21

Vendosja e porosisë

1. Përveç në rastet kur palët që nuk janë konsumatorë merren vesh ndryshe, atëherë ofruesi i shërbimit që merr porosinë me anë të mjeteve teknologjike, duhet të vërtetojë pranimin e porosisë së pranuesit pa një vonesë të duhur dhe me mjete elektronike. Porosia dhe konfirmimi konsiderohet se janë pranuar kur palët të cilave u adresohen janë në gjendje të kenë qasje në to.

2. Përveç në rastet kur palët që nuk janë konsumatorë merren vesh ndryshe, ofruesi i shërbimit vë në dispozicion të pranuesit të shërbimit mjetet teknike të përshtatshme, efektive dhe të përdorshme që i mundësojnë atij t'i identifikojë dhe përmirësojë gabimet e futura para se të bëhet porosia.

3. Dispozitat në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni nuk zbatohen për kontratat e arritura ekskluzivisht nga shkëmbimi i postës elektronike apo me komunikime ekuivalente individuale.

KREU VII

TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 22

Veprimet në lidhje me kontratat për transportin e mallrave

1. Ky Kre zbatohet për çfarëdo veprimi në lidhje me ose në zbatim të kontratës së transportit të mallrave, duke përfshirë, por jo kufizuar, në:

1.1. ofrimin e shenjave, numrit, sasisë ose të masës së mallrave;

- 1.2. paraqitjen e natyrës dhe të vlerës së mallrave;
- 1.3. lëshimin e faturës së mallrave;
- 1.4. konfirmimin se mallrat janë ngarkuar;
- 1.5. njoftimin e personit për afatet dhe për kushtet e kontratës;
- 1.6. dhënien e udhëzimeve për transportuesin;
- 1.7. kërkesën për furnizim të mallrave;
- 1.8. autorizimin e lëshuar për mallrat;
- 1.9. njoftimin për humbje ose dëmtim të mallrave;
- 1.10. dhënien e çfarëdo njoftimi tjetër ose deklarate në lidhje me kryerjen e kontratës;
- 1.11. aktivitetin për t'u furnizuar me mallra te personi i emëruar ose te personi i autorizuar për të kërkuar furnizim;
- 1.12. dhënien, sigurimin, refuzimin, nënshtrimin, transferimin ose negocimin e të drejtave për mallra;
- 1.13. sigurimin ose transferimin e të drejtave dhe të obligimeve sipas kontratës.

Neni 23 **Dokumentet e transportit**

1. Varësisht nga paragrafi 3. i këtij neni, kur ky ligj kërkon që ndonjë veprim që i referohet nenit 22 të këtij ligji të kryhet në formë të shkruar ose duke shfrytëzuar dokument letre që të plotësohet kërkesa nëse veprimi është kryer duke shfrytëzuar një ose më shumë mesazhe të të dhënave.
2. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet, kur kërkesa është obligim ose kur ligji thjeshtë paraqet pasojat e mos përmbushjes së kërkesave në të shkruar, si dokument në formë të letrës.
3. Nëse duhet të autorizohet ndokush, ose duhet të kryhet ndonjë obligim vetëm nga një person dhe nëse ligji këtë e kërkon në mënyrë që ta adresojë këtë çështje, të drejtat dhe obligimet duhet të barten tek ai person me transferimin ose me shfrytëzimin e dokumentit në format të letrës. Kjo kërkesë konsiderohet se është përmbushur nëse e drejta është bartur duke shfrytëzuar një apo më shumë mesazhe të të dhënave duke vërtetuar se është zbatuar metoda e besueshmërisë për paraqitje të mesazheve të tilla të të dhënave ose të mesazheve unike.

4. Për qëllimet e paragrafit 3. të këtij neni, standardi i kërkuar i besueshmërisë duhet të vlerësohet në qartësimin e qëllimit për të cilin e drejta ose obligimi është bartur dhe në qartësimin e të gjitha rrethanave, duke përfshirë edhe marrëveshjen relevante.

5. Kur shfrytëzohen një ose më shumë mesazhe të të dhënave, për të arritur efektin në ndonjë veprim në nën-paragrafët 1.6. dhe 1.7. të paragrafit 1. të nenit 22 të këtij ligji asnjë dokument në formë letre i shfrytëzuar për të pasur efekt në një veprim të tillë, nuk është valid përderisa shfrytëzimi i mesazheve të të dhënave është përfunduar ose zëvendësuar me shfrytëzimin e dokumenteve në formë letre. Dokumenti nga letra i shfrytëzuar në këto rrethana duhet të përmbajë deklaratën për një përfundim të tillë. Zëvendësimi i mesazheve të të dhënave nga dokumentet në formë letre, nuk do të kenë efekt në të drejtat as obligimet e palëve të përfshira.

6. Nëse një rregull e këtij ligjit është detyrimisht e zbatueshme, për të kontraktuar transportin e mallrave, e evidentuar nga dokumenti në formë letre, atëherë një rregull e tillë duhet të jetë e zbatueshme për atë kontratë të transportit të mallrave e evidentuar nga një apo më shumë mesazhe të të dhënave, për arsye se kontrata është evidentuar nga një ose më shumë mesazhe të të dhënave në vend të dokumentit në formë të letrës.

KREU VIII

PËRGJEGJËSIA E OFRUESVE TË SHËRBIMIT TE NDËRMJETËM

Neni 24

Kanali komunikues

1. Kur ofruesi i shërbimeve të shoqërisë informatike ofron një shërbim që përbëhet nga transmetimi i informatës nga marrësi i shërbimit në rrjetin e komunikimit ose nga ofrimi i qasjes në rrjetin e komunikimit, atëherë ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar, po qe se ai:

1.1. nuk e inicion transmetimin;

1.2. nuk e zgjedhë pranuesin e transmetimit;

1.3. nuk e zgjedh ose modifikon informacionin e përfshirë në transmetim (bartje).

2. Veprimet e transmetimit dhe të qasjes në lidhje me paragrafin 1. të këtij neni përfshijnë ruajtjen automatike, ndërmjetësuese dhe të përkohshme të informacionit të transmetuar për aq sa kjo ndodh vetëm për kryerjen e transmetimit në rrjetin e komunikimit, dhe me kusht që informacioni nuk është ruajtur për ndonjë periudhë më të gjatë sesa është e nevojshme arsyeshëm për transmetim.

Neni 25 Mbajtja

1. Kur një ofrues i shërbimeve të shoqërisë informatike ofron një shërbim që konsiston në transmetim në një rrjet komunikues të informatës për marrësin e shërbimit, atëherë ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të asaj informate, ruajtje që kryhet vetëm për ta bërë më efikase transmetimin e informacionit tek marrësit e tjerë të shërbimit sipas kërkesës së tyre, në rast se:

1.1. ofruesi nuk e modifikon informatën;

1.2. ofruesi zbaton kushtet e qasjes në informatë;

1.3. ofruesi zbaton rregullat që lidhen me freskimin e informatave, të specifikuara sipas mënyrave të njohura dhe të përdorura gjerësisht në industri;

1.4. ofruesi nuk ndërhyt në përdorimin e ligjshëm të teknologjisë, gjerësisht i njohur dhe i shfrytëzuar në industri, për të fituar të dhëna mbi përdorimin e informacionit; dhe

1.5. ofruesi vepron menjëherë për të hequr ose për të ndaluar qasjen në informacionin që ka ruajtur, sapo vihet në dijeni se informacioni në burimin fillestar të transmetimit është hequr nga rrjeti ose është ndaluar qasja, ose nëse një gjykatë apo autoritet administrativ ka urdhëruar këtë heqje ose ndalim të qasjes.

Neni 26 Nikoqirllëku

1. Kur ofruesi i shërbimit të shoqërisë informatike bën ruajtjen e informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit, ai nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur në kërkesë të marrësit të shërbimit në rast se:

1.1. Ofruesi i shërbimit nuk ka dijeni për aktivitetin ose informacionin e paligjshëm, dhe për sa i përket kërkesës për dëme nuk ka dijeni as për faktet e as për rrethanat që do ta bënin të qartë informacionin apo aktivitetin e paligjshëm; ose

1.2. Ofruesi i shërbimit, sapo të jetë në dijeni për situatën e mësipërme, vepron menjëherë për ta larguar apo për të ndaluar qasjen në atë informacion.

Neni 27 Përgjegjësia për dëmet që rrjedhin nga largimi ose pamundësimi i qasjes në informacion

1. Çdo person që njofton ofruesin e shërbimeve të Shoqërisë Informatike për aktivitet ose informacion ilegal detyrohet për dëmet që rrjedhin nga largimi ose pamundësimi i qasjes në informacion, referuar në nën-paragrafin 1.2. paragrafi 1. i nenit 26 të këtij ligji kur:

- 1.1. ai nuk ka vepruar me qëllime të sinqerta; ose
- 1.2. ai ka përfituar nga veprimet e ofruesit të shërbimeve të Shoqërisë Informatike; ose
- 1.3. ai e ka ditur, ose duhej të dinte, që informacioni ose aktiviteti nuk ishte ilegal.

Neni 28

Përfshirja nga obligimet e përgjithshme për monitorim

1. Ofruesit e shërbimeve të shoqërisë informatike, kur ofrojnë shërbimet që përfshihen në nenet e këtij kreu nuk kanë obligime të veçanta për të monitoruar informacionin që ata e transmetojnë ose e ruajnë e as obligime të përgjithshme që aktivisht të kërkojnë fakte ose rrethana ku tregohet aktiviteti ilegal.
2. Ofruesit e shërbimeve të shoqërisë informatike me shpejtësi do të informojnë autoritetet publike kompetente sipas legjislacionit në fuqi për çështjen e pretenduar të aktivitetit ilegal të ndërmarrë ose informacionit të dhënë nga marrësi i shërbimeve të tyre dhe do t'i japin çdo autoriteti të tillë në bazë të kërkesës, informacionin që mundëson identifikimin e marrësve në shërbimet e tyre me të cilët ata kanë marrëveshje për ruajtje.
3. Asgjë në këtë nen nuk interpretohet si detyrim ndaj ofruesve të shërbimeve të shoqërisë informatike për të monitoruar informacionin që ata transmetojnë ose e ruajnë ose që aktivisht të kërkojnë fakte ose informacion shtesë që dëshmon aktivitet ilegal në lidhje me aktivitetet e përshkruara në nenet 24, 25 dhe 26 të këtij ligji.

KREU IX

KONTRATAT NË DISTANCË

Neni 29

Definicioni dhe fushëveprimi

1. Kontrata në distancë paraqet kontratën në lidhje me mallra ose me shërbime të lidhura ndërmjet furnizuesit dhe konsumatorit sipas një shitjeje të bërë në distancë ose skemës së ofrimit të shërbimit që udhëhiqet nga furnizuesi i cili shfrytëzon mjetet e komunikimit në distancë, deri në momentin që lidhet kontrata.
2. Komunikimi në distancë përfshin çfarëdo mjeti që përdoret për të lidhur kontratë pa praninë fizike të furnizuesit dhe të konsumatorit. Shembujt e tillë mund të jenë, por nuk kufizohen në:
 - 2.1. përmbajtjet e shtypura të adresuara dhe të pa adresuara;

- 2.2. letrat standarde;
- 2.3. reklamimin në shtyp në formë porosie;
- 2.4. katalogun;
- 2.5. telefonatat me intervenimin e njeriut;
- 2.6. telefonimin pa intervenim të njeriut (makina e thirrjes automatike ose audioteksti);
- 2.7. radioja;
- 2.8. videofoni (telefoni me ekran);
- 2.9. videoteksti (mikrokompjuteri dhe ekрани televiziv) me tastaturë ose me ekran që preket;
- 2.10. posta elektronike;
- 2.11. makina faksimil (faksi);
- 2.12. televizioni (teleshopi).

Neni 30 **Përjashtimet**

1. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat:

- 1.1. e lidhura për shërbimet financiare ose të sigurimit për të cilat aplikohet marketingu në distance i shërbimeve financiare të konsumatorit;
- 1.2. e lidhura me mjete automatike të shitjes ose vendet automatike tregtare;
- 1.3. e lidhura me ofruesit e shërbimit të telekomunikimit me anë të shfrytëzimit të telefonave publik;
- 1.4. e lidhura për ndërtimin dhe shitjen e pasurisë së patundshme ose lidhur me të drejtat e tjera të pasurisë së patundshme përveç atyre të qirasë;
- 1.5. e lidhura në ankand.

2. Kërkesat që kanë të bëjnë me nenin 31, 32, 33 dhe 34 të këtij ligji nuk aplikohen për:

2.1. kontratat për furnizim me gjëra ushqimore, pije ose mallra të tjera të konsumit të përditshëm që furnizohen në shtëpi të konsumatorit, në vendbanimin e tij ose në vendin e tij të punës nga furnizuesit e rregullt të përditshëm;

2.2. kontratat për ofrimin e akomodimit, transportit, furnizimit me ushqime apo shërbime ndërmjetësuese që i ndërmerr furnizuesi në pajtim me kontratën, me përjashtim të veprimit të rrethanave të jashtëzakonshme, kur furnizuesi lirohet nga obligimi ndaj konsumatorit për t'i kthyer shumën e paguar.

Neni 31 **Informacioni paraprak**

1. Brenda një kohe të arsyeshme para se të lidhet kontrata në distance, konsumatorit duhet t'i ofrohen informacionet si vijon:

1.1. identitetin e furnizuesit dhe në rast se në kontratat kërkojnë pagesë në avans edhe adresën e tij;

1.2. karakteristikat kryesore të mallrave dhe shërbimeve;

1.3. çmimin e mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë edhe tatimin;

1.4. koston e transportit, kur kjo zbatohet;

1.5. aranzhimet për pagesë, transport ose kryerje;

1.6. e drejta për tërheqje;

1.7. koston e shfrytëzimit të mjeteve të komunikimit në distancë, kur llogaritja bëhet ndryshe nga çmimi bazë;

1.8. kohën, brenda së cilës oferta ose çmimi mbetet valid;

1.9. kur ekzistojnë kushtet, minimumi i kohëzgjatjes së kontratës në rastin e kontratave për furnizim me produkte ose shërbime që duhet të kryhen përherë apo në formë të përsëritur.

2. Informacioni i përmendur me sipër, qëllimi komercial i të cilit duhet të jetë i qartë, ofrohet në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse në përshtatje me mjetet e përdorura të komunikimit në distancë. Duhet respektuar me kujdes parimet e mirëbesimit në transaksionet tregtare dhe parimet që mbrojnë ata që janë të paafte për të dhënë pajtimin sipas legjislacionit në fuqi (p.sh. të miturit).

3. Në rastin e komunikimeve telefonike, duhet të bëhen veçanërisht të qarta identiteti i furnizuesit dhe qëllimi komercial i thirrjes dhe kjo duhet të jetë në fillim të të gjitha bisedave me konsumatorët.

Neni 32

Konfirmimi me shkrim i informacionit

1. Konsumatori duhet të marrë konfirmim me shkrim ose me ndonjë medium tjetër të qëndrueshëm dhe të qasshëm për të, për informacionin e përmendur në nenin 31 të këtij Ligji. Nëse ky informacion nuk i është dhënë konsumatorit para lidhjes së kontratës, atëherë duhet t'i ofrohet sa më shpejt gjatë përmbushjes së kontratës dhe më së voni në kohën e dorëzimit të mallit.

2. Në çdo rast, këto informacione duhet të përmbajnë:

2.1. informacion të shkruar për kushtet dhe procedurat e ushtrimit të së drejtës për t'u tërhequr;

2.2. adresën fizike të vendit të biznesit të furnizuesit të cilit konsumatori mund t'ia adresoj ndonjë ankesë;

2.3. informacionin për shërbimet pas shitjes dhe garancitë që ekzistojnë;

2.4. vendimin për anulimin e kontratës, aty ku kohëzgjatja është e paspecifikuar ose kohëzgjatja kalon një 1 vit.

3. Këto informacione nuk janë të nevojshme për shërbimet të cilat janë kryer përmes shfrytëzimit të mjeteve të komunikimit në distance ku furnizimi është bërë vetëm në një rast dhe që janë faturuar nga ofruesi i shërbimit me anë të mjeteve të komunikimit në distancë. Konsumatori duhet që në të gjitha rastet të jetë në gjendje të marrë adresën e vendit të biznesit të furnizuesit të cilit mund t'ia adresoj çfarëdo ankesë.

Neni 33

E drejta për t'u tërhequr

1. Për kontratën në distancë, konsumatori duhet të ketë kohën prej të paktën shtatë (7) ditë pune brenda së cilës ai mund të tërhiqet nga kontrata.

2. Obligimi i vetëm për konsumatorin, për shkak të ushtrimit të së drejtës së tërheqjes është kostoja e drejtpërdrejtë e kthimit të mallit.

3. Koha për ushtrimin e kësaj së drejte fillon:

3.1. në rastin e mallrave, nga dita e pranimit nga konsumatori ku obligimi lidhur me konfirmimin me shkrim të informacionit është plotësuar;

3.2. në rastin e shërbimeve, nga dita e lidhjes së kontratës apo nga dita në të cilën obligimet lidhur me konfirmimin me shkrim të informacionit janë plotësuar nëse ato janë plotësuar pas lidhjes së kontratës, me kusht që kjo kohë të mos kalojë tre (3) muaj.

4. Nëse furnizuesi ka dështuar të plotësojë obligimet lidhur me konfirmimin me shkrim të informacionit, koha e plotësimit të atyre obligimeve do të jetë tre (3) muaj. Kjo kohë duhet të fillojë:

4.1. në rastin e mallrave, nga dita e pranimit nga konsumatori;

4.2. në rastin e shërbimeve, nga dita e lidhjes së kontratës.

5. Nëse detyrimi i konfirmimit të shkruar të informacionit është plotësuar brenda tre (3) muajsh, koha prej shtatë (7) ditësh, sipas paragrafit 1. të këtij neni do të fillojë nga ai moment.

6. Nëse konsumatori ka ushtruar të drejtën e tij për t'u tërhequr, furnizuesi duhet të jetë i obliguar t'i kompensojë shumat e paguara nga konsumatori, kurse konsumatori nuk ka nevojë të paguajë diçka për këtë. Të vetmen pagesë që duhet ta bëjë konsumatori është kostoja e shkaktuar për kthimin e mallit. Një kompensim i tillë duhet të kryhet jo më shumë se tridhjetë (30) ditë.

7. Përveç në rastin kur palët merren vesh ndryshe, konsumatori nuk mund të ushtrojë të drejtën e vet për t'u tërhequr në lidhje me kontratat:

7.1. për ofrimin e shërbimit nëse kryerja e shërbimit ka filluar me marrëveshje me konsumatorin para se të kenë kaluar shtatë (7) ditë pune sipas paragrafit 1. të këtij neni:

7.2. për furnizim në mallra të bëra për specifikimet e konsumatorit ose për ato që qartë janë personalizuar ose për shkak të natyrës a përbërjes së tyre deformimin e shpejtë, ose afati u kalon shpejtë;

7.3. për ofrimin e regjistrimit të zërit ose të atyre video, a të programeve të kompjuterëve që janë hapur nga konsumatori;

7.4. për furnizim të gazetave të përditshme, periodike dhe të revistave;

7.5. për lojërat dhe shërbimet e lotarisë.

8. Nëse çmimi i mallrave ose i shërbimeve plotësisht ose pjesërisht është i mbuluar me kredi të dhënë nga furnizuesi, ose nëse çmimi është plotësisht a pjesërisht i mbuluar me kredi të dhënë për konsumatorin nga një palë e tretë sipas marrëveshjes ndërmjet palës së tretë dhe furnizuesit, marrëveshja e kredisë duhet të anulohet pa ndonjë dënim nëse konsumatori e ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga kontrata.

Neni 34

Performanca

1. Përveç në rastet kur palët merren vesh ndryshe, furnizuesi duhet ta kryejë porosinë brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita në vazhdim në të cilën konsumatori ka paraqitur porosinë tek furnizuesi.
2. Kur furnizuesi nuk e plotëson pjesën e vet të kontratës me arsyen se mallrat ose shërbimet e porositura nuk janë në dispozicion, konsumatori duhet të informohet për këtë situatë dhe duhet t'i kthehet shuma që ka paguar menjëherë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë.
3. Furnizuesi mund t'i ofrojë konsumatorit mallra ose shërbime të cilësisë së lartë por me çmim të njëjtë, me kusht që kjo mundësi të jetë ofruar para lidhjes së kontratës ose pasi të lidhet ajo. Kostoja e kthimit të mallit në pasim të ushtrimit të së drejtës për t'u tërhequr në çdo rast duhet të mbulohet nga furnizuesi, kurse konsumatori duhet të informohet për këtë gjë. Në raste të tilla furnizimi i mallrave nuk mund të merret se përbën shitje inerciale bazuar në nenin 36 të këtij ligji.

Neni 35

Anulimi i pagesës më kartelë në rast mashtrimi

1. Konsumatori ka të drejtë:
 - 1.1. të kërkojë anulimin e pagesës në rast mashtrimi në kartelën e pagesës së tij me kartelë, në lidhje me kontratat në distancë sipas këtij ligji;
 - 1.2. në rast mashtrimi, t'i rikompensohet shuma e paguar ose t'i kthehet pagesa.

Neni 36

Shitje inerciale

1. Është i ndaluar ofrimi i mallrave ose shërbimeve tek konsumatori pa qenë të porositura ato më parë nga konsumatori, aty ku ofrimi i tillë përfshinë kërkesën për pagesë.
2. Konsumatorit nuk do ti kërkohet asgjë për rastet e furnizimit të pa kërkuar. Mungesa e përgjigjes për këto raste nuk përbën pranim.

Neni 37

Pëlqimi paraprak I konsumatorit për shfrytëzimin e disa mjeteve për komunikimet në distancë

1. Konsumatori duhet të jap pëlqimin paraprak që furnizuesi të përdor:

1.1. sistemi automatik i thirrjeve pa ndërhyrje të dorës së njeriut - aparate automatike të thirrjeve;

1.2. aparate faksimil - faks.

2. Mjete të tjera të komunikimit në distancë, që mundësojnë komunikim individual, mund të shfrytëzohen vetëm nëse nuk ka vërejtje të qartë nga konsumatori.

Neni 38

Korrigjimi juridik ose administrativ

1. Për të siguruar se ky ligj është në zbatim si duhet, mund të ndërmerren veprime sipas ligjit në fuqi pranë gjykatave ose organeve administrative kompetente siç janë:

1.1. organet publike ose përfaqësuesit e tyre;

1.2. organizatat e konsumatorëve;

1.3. organizatat profesionale.

Neni 39

Natyra obliguese

Konsumatori mund të mos heqë dorë nga të drejtat që i jepen atij me këtë ligj. Konsumatori nuk humb mbrojtjen që i është dhënë sipas ligjit të zgjedhur nga juridiksioni i jashtëm si ligj i zbatueshëm në kontratë.

KREU X

FATURAT NË FORMËN ELEKTRONIKE

Neni 40

Detajet e kërkuara për faturat

1. Për faturim në tregtinë elektronike kërkohet:

1.1. data e lëshimit;

1.2. numri vijues, i bazuar në një ose më shumë numra vijues që identifikojnë faturat;

1.3. numri identifikues i TVSH-së, sipas të cilit obliguesi tatimor furnizon me mallra ose shërbime (nëse është e zbatueshme);

- 1.4. emrin e plotë dhe adresën e obliguesit tatimor dhe të konsumatorit të tij;
 - 1.5. sasinë, çmimin për njësi dhe natyrën e mallrave të furnizimit ose shtrirjen e tyre dhe natyrën e shërbimeve të ofruara;
 - 1.6. datën në të cilën është bërë ose është kryer furnizimi me mallra ose me shërbime, ose datën në të cilën është bërë pagesa në xhirollogari, ashtu që data të mund të përcaktohet dhe dallohet nga data e lëshimit të faturës;
 - 1.7. tatimi për vlerë ose përjashtim, njësia e çmimit që përjashtohet nga tatimi dhe ndonjë zbritje çmimi ose kompensimi nëse ato nuk janë përfshirë në njësinë e çmimit;
 - 1.8. shkallën e TVSH-së së zbatuar;
 - 1.9. shumën e TVSH-së që duhet të paguhet.
2. Nuk kërkohet që fatura të nënshkruhet.
 3. Shuma që paraqitet në faturë mund të shprehet në çfarëdo valute, me kusht që shuma e tatimit që duhet të paguhet të shprehet në euro.

Neni 41

Faturat në letër ose me anë të mjeteve elektronike

1. Faturat mund të dërgohen qoftë në formë të letrës ose nëse konsumatori pranon, mund të dërgohen edhe në formën elektronike. Faturat e dërguara me anë të mjeteve elektronike, duhet të jenë të pranueshme në Kosovë, me kusht që të garantohen vërtetësia e prejardhjes dhe integriteti i përmbajtjes:
 - 1.1. nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar; ose
 - 1.2. nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar që duhet të bazohet në një certifikatë të kualifikuar dhe të krijuar nga një pajisje për krijimin e nënshkrimit të sigurt; ose
 - 1.3. nëpërmjet shkëmbimit elektronik të ë dhënave (SHEDH) kur marrëveshja e shkëmbimit ofrohet për shfrytëzimin e procedurave që garantojnë vërtetësinë e origjinës dhe tërësinë e të dhënave.
 - 1.4. nëpërmjet mjeteve të tjera elektronike të miratuara nga Ministri përmes aktit nënligjor.
2. Faturat mund të dërgohen me anë të mjeteve të tjera elektronike me kusht që të pranohen në mënyrë eksplicite nga klienti.

3. Kur grupet që i përfshinë disa fatura janë dërguar me anë të mjeteve elektronike të marrësi i njëjtë, detajet e përbashkëta për faturat e veçanta mund të përmenden vetëm një herë, nëse për secilën faturë të gjitha informacionet janë të qasshme.

Neni 42

Ruajtja e faturave

1. Secili obligues tatimor duhet të sigurojë se kopjet e faturave që i ka lëshuar vetë dhe të gjitha faturat që ai i ka marrë, të ruhen sipas Ligjit përkatës tatimor të Kosovës ashtu siç është miratuar nga Ministria e Financave.

2. Obliguesi tatimor mund të vendosë për vendin e ruajtjes me kusht që ai të bëjë që faturat ose informacioni i ruajtur aty të jetë i qasshëm për autoritetet kompetente kurdo që ata kërkojnë një gjë të tillë.

3. Vërtetësia e origjinës dhe tërësia e përmbajtjes së faturave, gjithashtu edhe lexueshmëria e tyre, duhet të garantohen gjatë tërë kohës sa ato ruhen. Në mënyrë që të sigurohet se këto kushte janë plotësuar, faturat mund të ruhen në formën e tyre origjinale në të cilën ato janë dërguar qoftë ato në formë elektronike apo në formë letre. Kur faturat ruhen me mjete elektronike, gjithashtu duhet të ruhen edhe të dhënat që garantojnë vërtetësinë e origjinës dhe tërësinë e përmbajtjes.

4. Ministria e Financave duhet ta përcaktojë kohën për të cilën obliguesit tatimorë duhet t'i ruajnë faturat lidhur me mallrat dhe shërbimet e furnizimit në territorin e tyre dhe faturat e pranuar nga tatimpaguesit e regjistruar në Kosovë.

5. Transmetimi dhe ruajtja e faturave me mjete elektronike nënkupton transmetimin ose vënien në dispozicion të pranuesit dhe ruajtjen duke shfrytëzuar pajisjen elektronike për procesim (duke përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtjen e të dhënave duke përdorur telat, radio transmetuesit, teknologjinë optike ose mjetet e tjera elektromagnetike.

KREU XI

PAGESAT ELEKTRONIKE

Neni 43

Zbatimi i pagesave elektronike

1. Ky ligj zbatohet për pagesat elektronike dhe vendosjen e kushteve që duhet të plotësohen nëse mënyrat e reja të pagesës elektronike do të zhvillohen në të mirë të të gjithë partnerëve ekonomikë dhe që krijojnë:

1.1. për konsumatorët, siguri dhe komoditet;

1.2. për tregtarët dhe lëshuesit, siguri më të madhe dhe produktivitet;

1.3. zhvillim të industrisë në Kosovë.

2. Parimet e praktikave të drejta duhet të vëzhgohen nga ana e atyre që i fusin në funksion sistemet e pagesave me kartelë ose që mundësojnë shfrytëzimin e këtyre kartelave.

3. Zhvillimi teknologjik i mjeteve elektronike të pagesës duhet ta ketë parasysh dimensionin e tyre evropian: mjetet e tilla duhet të kenë ndërveprim të gjerë sa më shumë që të jetë e mundshme, për të shmangur sistemet e izoluar dhe me këtë ndarjen e tregut.

4. Ky ligj nuk do të zbatohet tek:

4.1. kartelat që nuk kanë vlerë monetare ekuivalente;

4.2. kartelat që lëshohen nga një kompani specifike, nëse ajo kompani është e vetmja ku ato kartela ose vlera në to mund të përdoret.

Neni 44 Kontratat

1. Kontratat e lidhura ndërmjet lëshuesve ose agjentëve të tyre, me tregtarët dhe zotëruesit duhet të jenë në formë të shkruar dhe si rezultat i aplikimit paraprak. Ato duhet të përmbajnë detajet për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të marrëveshjes.

2. Kontratat duhet të përpilohen në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

3. Çdo lloj i tarifimit duhet të përcaktohet në mënyrë transparente, duke marrë parasysh kostot dhe rrezikun, por pa e kufizuar konkurrencën.

4. Të gjitha kushtet, nëse janë në përputhje me ligjet në fuqi duhet të negociohen dhe të shprehen qarte në kontratë.

5. Kushtet e veçanta për ndërprerjen e kontratës duhet të përfshihen në kontratë, kurse palët duhet të njoftohen para se të lidhet një kontratë e tillë.

Neni 45 Interoperabiliteti

Interoperabiliteti duhet të jetë i plotë në mënyrë që tregtarët dhe konsumatorët të mund të shfrytëzojnë rrjetet ose të kontraktojnë me lëshuesin e zgjedhur, me të gjitha terminalet në gjendje për ti procesuar të gjitha llojet e kartelave.

Neni 46

Pajisja

1. Terminalet për pagesa elektronike duhet ti regjistrojnë, kontrollojnë dhe transmetojnë pagesat, në mënyrë që të integrohen në терминаlet e pikave të shitjes.
2. Tregtarët kanë mundësi të vendosin nëse dëshirojnë një apo më shumë terminale të karteleve të llojeve të ndryshme.
3. Tregtarët duhet të jenë të lirë të zgjedhin se cilin terminal të pikës së shitjes do ta vendosin. Ata duhet të kenë liri ta marrin me qira ose të blejnë një pajisje të tillë me kusht që të jetë e certifikuar për ti përmbushur kërkesat e tërë sistemit të pagesave dhe të jenë interoperabile.

Neni 47

Mbrojtja dhe siguria e të dhënave

1. Pagesat elektronike janë të pakthyeshme. Urdhri i dhënë përmes kartelave për pagesa elektronike duhet të jetë i përvokueshëm dhe nuk mund anulohet.
2. Informacioni i transmetuar gjatë kohës kur bëhet pagesa për bankën përkatëse të tregtarit dhe më pas për lëshuesin, nuk duhet në asnjë mënyrë të ndikojë në mbrojtjen e privatësisë. Duhet të jetë rreptësisht e kufizuar në atë që është paraqitur në çeqe ose transfere.
3. Çfarëdo problemi qoftë që ka të bëjë me mbrojtjen ose me sigurinë e informacionit, duhet të bëhet i njohur haptas dhe të qartësohet në çfarëdo faze të kontratës ndërmjet palëve.
4. Kontratat nuk duhet ta kufizojnë lirinë e tregtarit për të zhvilluar veprimtarinë ose për konkurrencë.

Neni 48

Qasja e paanshme në sistem

1. Pa marrë parasysh madhësinë e tyre ekonomike, të gjitha ndërmarrjeve duhet t'u lejohej qasje e paanshme në sistemin e pagesës elektronike. Tregtarit mund t'i refuzohet qasja vetëm për rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.
2. Nuk duhet të ketë dallime të pajustificueshme në pagesa për transaksionet brenda Kosovës, si dhe për pagesat për të njëjtat shërbime për transaksionet ndërkombëtare me vendet e tjera, veçanërisht me vendet e rajonit.

Neni 49
Raportet ndërmjet lëshuesve dhe tregtarëve

1. Për t'i dhënë shtytje qasjes reciproke ndërmjet sistemeve të ndryshme me kartela, kontratat ndërmjet lëshuesve të kartelave dhe tregtarëve, nuk duhet të përmbajnë kurrfarë klauzole përjashtuese që kërkon nga tregtari të operojë vetëm me sistemin me të cilin ka bërë në marrëveshje.
2. Kontratat me tregtarët duhet të lejojnë konkurrencë efektive ndërmjet lëshuesve të ndryshëm. Dispozitat detyrimisht duhet të kufizohen në kërkesat teknike, në mënyrë që të sigurohet se sistemi funksionon si duhet.

Neni 50
Raportet ndërmjet lëshuesve dhe konsumatorëve

Në kontratën që ata e nënshkruajnë, zotëruesit e kartelave duhet t'i marrin të gjitha masat e nevojshme paraprakisht për ta garantuar sigurinë e kartelës së lëshuar dhe të njoftohen për kushtet e veçanta (humbje apo vjedhje).

Neni 51
Raportet ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve

Tregtarët duhet të paraqesin në mënyrë plotësisht të dukshme shenjat e kompanive me të cilat ata bashkëpunojnë, lidhur me këtë ata janë të obliguar t'i pranojnë kartelat e tilla.

KREU XII
NËNSHKRIMET ELEKTRONIKE

Neni 52
Trajtimi i Barabartë i Teknologjive të Nënshkrimit

Përveç nenit 54 të këtij ligji, asgjë në këtë ligj nuk do të zbatohet në mënyrë të tillë që do të përjashtojë, kufizojë apo shfuqizojë efektet ligjore të çfarëdo metode për krijimin e një nënshkrimi elektronik që përmbush kërkesat e paraqitura në paragrafin 1. të nenit 55 të këtij ligji, ose përndryshe i përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 53
Ndryshimet me marrëveshje

Dispozitat e këtij Kreu të ligjit mund të përjashtohen, apo ndikimi i tyre mund të ndryshohet me marrëveshje përpos në rastet kur kjo marrëveshje nuk është e vlefshme apo e fuqizuar nga legjislati në fuqi.

KREU XIII
PËRDORIMI I NËNSHKRIMEVE

Neni 54
Pajtueshmëria me kërkesën për nënshkrim

1. Një nënshkrim elektronik konsiderohet të jetë i besueshëm për qëllim të plotësimit të kërkesave të referuara në nenin 6 të këtij ligji, nëse:

- 1.1. janë plotësuar kërkesat për nënshkrim elektronik të avancuar;
- 1.2. është i bazuar në certifikatë të kualifikuar;
- 1.3. është krijuar me pajisje për krijimin e nënshkrimit të sigurt.

2. Një nënshkrim elektronik nuk konsiderohet të jetë me besueshmëri të pamjaftueshme vetëm në bazë të asaj se:

- 2.1. nuk është i bazuar në certifikatë të kualifikuar; ose
- 2.2. nuk bazohet në certifikatë të kualifikuar të lëshuar nga ofruesi i akredituar i shërbimeve të certifikimit, ose
- 2.3. nuk është krijuar me pajisje për krijimin e nënshkrimit të sigurt.

3. Vetëm nëse nënshkrimi elektronik është në formë të një nënshkrimi elektronik të avancuar, që është i bazuar në certifikatë të kualifikuar dhe është krijuar me pajisje për krijimin e nënshkrimit të sigurt, për të gjitha qëllimet dhe synimet e këtij ligji do të konsiderohet se nënshkrimi është i nënshkruesit.

4. Paragrafi 1. i këtij neni nuk kufizon mundësinë e cilitdo personi:

- 4.1. për të krijuar në ndonjë mënyrë tjetër, për qëllim të plotësimit të kërkesave të referuara në nenin 6 të këtij ligji, besueshmërinë e një nënshkrimi elektronik; ose
- 4.2. që të sjell fakte për jo besueshmërinë e një nënshkrimi elektronik.

Neni 55

Zbatueshmëria

1. Ministri mund të përcaktoj me akt nënligjor se cili nënshkrim elektronik i plotëson dispozitat e paragrafit 2. të nenit 54 të këtij ligji, dhe mund të krijoj rregulla për ti dhënë efekt të plotë pranimit dhe përdorimit të nënshkrimeve elektronike.
2. Çfarëdo përcaktimi i bërë në paragrafin 1. të këtij neni duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare dhe legjislacionin Evropian në fuqi.
3. Asgjë në këtë nen nuk ndikon në veprimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Neni 56

Veprimet e nënshkruesit

1. Kur të dhënat e nënshkrimit mund të përdoren për të krijuar një nënshkrim me efekt ligjor, secili nënshkrues duhet:
 - 1.1. të ketë kujdes adekuat për t'iu shmangur përdorimit të paautorizuar të të dhënave për krijim të nënshkrimit të tij;
 - 1.2. që pa ndonjë vonesë të paarsyeshme t'i shfrytëzojë mjetet e vëna në dispozicion nga ofruesi i shërbimeve të certifikimit, në pajtim me nenin 57 të këtij ligji, ose në ndonjë mënyrë tjetër bën përpjekje të arsyeshme, që të njoftojë çdo person që në mënyrë të arsyeshme pritet nga nënshkruesi që të mbështetet ose të ofrojë shërbime duke shfrytëzuar nënshkrimin elektronik nëse:
 - 1.2.1. nënshkruesi ka njohuri se të dhënat e nënshkrimit të krijuar janë komprometuar ose
 - 1.2.2. rrethanat e njohura për nënshkruesin paraqesin rrezik thelbësor se të dhënat e nënshkrimit të krijuar mund të jenë komprometuar.
 - 1.3. kur certifikata përdoret për mbështetje të një nënshkrimi elektronik, të ushtrojë kujdes të arsyeshëm për të siguruar precizitet dhe kompletim të të gjitha materialeve të prezantuara, të bëra nga nënshkruesi dhe që janë relevante për certifikatën gjatë tërë ekzistencës së saj ose që do të përfshihen më tej në certifikatë.
2. Për dështimet e tij për përmbushje të kërkesave të paragrafit 1. të këtij neni nënshkruesi do t'i bartë pasojat ligjore.

Neni 57
Veprimet e ofruesit të shërbimeve të certifikimit

1. Kur një ofrues i shërbimeve të certifikimit ofron shërbime për të mbështetur një nënshkrim elektronik që mund të shfrytëzohet për efekt ligjor si nënshkrim, ai ofrues i shërbimeve të certifikimit duhet të:

1.1. veprojë sipas prezantimeve të bëra nga ai për sa i përket politikave dhe praktikave të tij;

1.2. ketë kujdes adekuat për të siguruar saktësinë dhe kompletimin e materialeve të prezantuara, të bëra nga nënshkruesi dhe që janë relevante për certifikatën gjatë tërë ekzistencës së saj ose që do të përfshihen më tej në certifikatë.

1.3. ofron mënyra të arsyeshme që i mundësojnë palës së besueshme, mbështetur në certifikatë të përcaktoj:

1.3.1. identitetin e ofruesit të shërbimeve të certifikimit;

1.3.2. që nënshkruesi që është identifikuar në certifikatë ka pasur nën kontroll të dhënat për krijimin e nënshkrimit në kohën kur certifikata është lëshuar;

1.3.3. që të dhënat për krijimin e nënshkrimit ishin të vlefshme para ose në kohën kur është dhënë certifikata;

1.4. ofroj mënyra të arsyeshme që i mundësojnë palës së besueshme të përcaktojë nga certifikata, kur është relevante apo në ndonjë mënyrë tjetër:

1.4.1. metodën e përdorur për të identifikuar nënshkruesin;

1.4.2. çdo kufizim sa i përket qëllimit ose vlerës për të cilën të dhënat për krijimin e nënshkrimit ose certifikata mund të përdoret;

1.4.3. që të dhënat për krijimin e nënshkrimit janë të vlefshme dhe nuk janë komprometuar;

1.4.4. çdo kufizim për fushëveprimin ose shtrirjen e përgjegjësisë të përcaktuar nga ofruesi i shërbimeve të certifikimit;

1.4.5. se a ka mjet për nënshkruesin për të lajmëruar në pajtim me nën-paragrafin 1.2. paragrafi 1. i nenit 56 të këtij ligji;

1.4.6. se a është ofruar shërbimi i duhur i revokimit;

1.5. ofron një mënyrë për nënshkruesin për të lajmëruar në pajtim me nën-paragrafin 1.2 paragrafit 1. të nenit 56 të këtij ligji aty ku janë ofruar shërbimet e nën-paragrafit

1.4.5 të këtij neni dhe siguron që të jetë në dispozicion shërbimi i duhur i revokimit aty ku janë ofruar shërbimet e paragrafit 1.4.6 të këtij neni;

1.6. shfrytëzon sistemet, procedurat dhe resurset njerëzore të besueshme gjatë kryerjes së shërbimeve të tij.

2. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit do t'i bartë pasojat ligjore për dështimet e tij në përmbushjen e kërkesave të paragrafit 1. të këtij neni.

3. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit, që lëshon certifikata të kualifikuara, do të:

3.1. demonstroj besueshmërinë e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve të certifikimit;

3.2. siguroj funksionimin e një direktoriumi të shpejtë dhe të sigurt dhe shërbim të revokimit të sigurt dhe të menjëhershëm.

3.3. siguroj që data dhe koha kur një certifikatë është lëshuar ose revokuar të mund të përcaktohet saktësisht;

3.4. verifikon, me mjete të përshtatshme sipas ligjeve në fuqi, identitetin dhe, nëse është e zbatueshme, çdo atribut specifik të personit që i është lëshuar certifikata e kualifikuar;

3.5. punësoj personel që kanë njohuri profesionale, eksperiencë, dhe kualifikim të duhur për shërbimet e ofruara, veçanërisht kompetencë në nivel menaxhues, njohuri speciale në teknologjinë e nënshkrimit elektronik dhe që i njohin procedurat e duhura të sigurisë; ai duhet gjithashtu të zbatoj procedurat administrative dhe menaxhuese që janë të përshtatshme dhe korrespondojnë me standardet e pranuar.

3.6. përdor sisteme dhe produkte të besueshme që janë të mbrojtura kundër modifikimeve dhe garantojnë sigurinë teknike dhe kriptografike të procesit të përkrahura nga ato;

3.7. merr masa kundër falsifikimit të certifikatave dhe në rastet kur ofruesi i shërbimeve të certifikimit i prodhon të dhënat për krijimin e nënshkrimit do të garantojë fshehtësinë gjatë procesit të prodhimit të të dhënave;

3.8. mbaj burime të mjaftueshme financiare që të funksionoj në pajtim me kërkesat e paraqitura në legjislacionin përkatës evropian për nënshkrim elektronik veçanërisht për të mbart rrezikun e detyrimeve për dëmet, për shembull, me marrjen e sigurimit të duhur;

3.9. regjistroj të gjithë informacionin relevant lidhur me një certifikatë të kualifikuar për një periudhë të duhur kohore, veçanërisht për qëllim të ofrimit të dëshmisë së certifikatës për qëllim të procedimit ligjor. Regjistrimi i tillë mund të bëhet në mënyrë elektronike;

3.10. nuk do të ruaj apo kopjoj të dhënat për krijimin e nënshkrimit të atij personi që ofruesi i shërbimeve të certifikimit i ka dhënë shërbimet e menaxhimit të çelësit;

3.11. para hyrjes në një marrëdhënie kontraktuale me një person që kërkon një certifikatë për të përkrahur nënshkrimin e tij elektronik do të informoj atë person për kohëzgjatjen e vlefshmërisë, për termet dhe kushtet e sakta në lidhje me përdorimin e certifikatës, duke përfshirë çdo kufizim për përdorimin e tij, ekzistimin e një skeme të akreditimit vullnetar dhe procedurat për ankim dhe zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve. Informacioni i tillë, që mund të transmetohet në mënyrë elektronike, duhet të jetë në formë të shkruar dhe në gjuhë të kuptueshme lehtë. Pjesët relevante të këtij informacioni duhet gjithashtu të vihen në dispozicion me kërkesë tek pala e tretë që mbështetet në certifikatë;

3.12. përdor sisteme të besueshme për të ruajtur certifikatat në një formë të verifikueshme ashtu që vetëm personat e autorizuar mund të kenë qasje dhe bëjnë ndryshime, informacioni mund të kontrollohet për autenticitet, korrigjimi i certifikatave mund të bëhet në mënyrë publike me kusht që të merret pëlqimi i mbajtësit të certifikatës, dhe çdo ndryshim teknik që i komprometon këto kërkesa të sigurisë janë të dukshme për operatorin.

Neni 58

Lista e besueshme

1. Ministria do të mirëmbajë regjistrin e ofruesve të shërbimeve të certifikimit të themeluar në Kosovë.
2. Regjistri i referuar në paragrafin 1. të këtij neni duhet të jetë në dispozicion për të gjithë dhe për lexuesit automatik që mbështeten në standardet që shfrytëzohen në Bashkimin Evropian dhe duhet të jetë i besueshëm, i azhurnuar dhe i sigurt.
3. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit mund të kërkojë që të regjistrohet në këtë listë nëse ai i plotëson kërkesat e nenit 57 dhe është themeluar në Kosovë dhe në fund jep të gjithë informacionin që Ministria mendon se është relevante.
4. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit do të njoftoj menjëherë Ministrinë për ndryshimet në informacionin relevant, duke përfshirë ndërprerjen e shërbimeve ose pamundësinë e tij që të pajtohet me çdo kërkesë të nenit 57 të këtij ligji.

Neni 59

Autoriteti mbikëqyrës

1. Ministria mund të autorizoj një organ publik ose privat, që të mbajnë regjistrin dhe ushtrojnë autoritetin mbikëqyrës.

2. Në kontekst të mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimeve të certifikimit të themeluar në Kosovë, Ministria mund të definojë çështjet që kanë të bëjnë me:

2.1. autoritetin dhe funksionet e autoritetit mbikëqyrës;

2.2. çdo çështje tjetër që do të jetë e nevojshme ose e dëshirueshme në lidhje me autoritetin mbikëqyrës që mund të shfaqet te Ministria.

Neni 60 Besueshmëria

1. Për qëllime të nënparagrafi 1.6 të paragrafit 1. të nenit 57, të këtij Ligji, për përcaktimin ose deri në çfarë mase, sistemet, procedurat dhe resurset njerëzore të shfrytëzuara nga ofruesi i shërbimit të certifikimit janë të besueshme, duhet kushtuar vëmendje faktorëve në vijim:

1.1. burimeve financiare dhe njerëzore duke përfshirë ekzistimin e aseteve;

1.2. cilësisë së sistemeve të harduerit dhe softuerit;

1.3. procedurave për procesimin e certifikatave dhe aplikacioneve të certifikatave si dhe mirëmbajtja e shënimeve;

1.4. informatave që janë në dispozicion për nënshkruesit e identifikuar në certifikata dhe për palët potenciale të besueshme;

1.5. rregullsisë dhe masës së auditimit nga ana e një organi të pavarur;

1.6. ekzistencës së deklaratës nga Ministria, autoritetit mbikëqyrës, organit të akredituar ose ofruesit të shërbimeve të certifikimit për përputhjen ose ekzistimin e faktorëve të shënuar më lartë; ose

1.7. çdo faktori tjetër relevant.

Neni 61 Veprimet e Palës së Besueshme

1. Pavarësisht nga paragrafi 3. i nenit 12 të këtij ligji, pala e besueshme do t'i bartë pasojat ligjore për dështimin e vet:

1.1. për të ndërmarr hapa të arsyeshëm për të verifikuar besueshmërinë e një nënshkrimi elektronik; ose

1.2. për të ndërmarrë hapa të arsyeshëm, kur nënshkrimi elektronik mbështetet nga certifikata:

1.2.1. që të verifikojë vlefshmërinë, suspendimin ose revokimin e certifikatës dhe

1.2.2. që të zbatojë çfarëdo kufizimi në lidhje me certifikatën.

Neni 62

Njohja e certifikatave dhe nënshkrimeve elektronike të huaja

1. Gjatë përcaktimit nëse, apo deri në çfarë mase certifikata apo nënshkrimi elektronik janë juridikisht të plotfuqishme, nuk do të merren në konsideratë:

1.1. vendi ku certifikata është lëshuar apo se ku është krijuar ose përdorur nënshkrimi elektronik; ose

1.2. vendndodhja e biznesit të lëshuesit ose nënshkruesit.

2. Certifikata e lëshuar jashtë Kosovës do të ketë të njëjtën fuqi ligjore në Kosovë si certifikata e lëshuar në Kosovë nëse ofron nivel substancialisht të barabartë të besueshmërisë.

3. Një nënshkrimi elektronik i krijuar ose i përdorur jashtë Kosovës do të ketë të njëjtën fuqi ligjore në Kosovë si nënshkrimi elektronik i krijuar ose i shfrytëzuar në Kosovë nëse ai ofron nivel substancialisht të barabartë të besueshmërisë.

4. Gjatë përcaktimit se a ofron certifikata ose nënshkrimi elektronik nivel substancialisht të barabartë të besueshmërisë për qëllimet e paragrafit 2. apo 3. të këtij neni, do të merren në konsideratë standardet e pranuar ndërkombëtare dhe ato të çfarëdo faktorëve të tjerë relevantë.

5. Certifikatat e lëshuara nga ofruesit e huaj të shërbimeve të certifikimit janë të barabarta me certifikatat e lëshuara nga ofruesit e shërbimeve të certifikimit në Kosovë, nëse ofruesi i shërbimeve të certifikimit të huaj është:

5.1. akredituar në një vend anëtar të Bashkimit Evropian, ose

5.2. nëse certifikatat e tyre janë garantuar nga një ofrues i shërbimeve të certifikimit i themeluar në Bashkimin Evropian.

6. Kur pavarësisht prej paragrafëve 2., 3. dhe 4. të këtij neni, palët pajtohen ndërmjet veti, të përdorin llojet e caktuara të nënshkrimeve elektronike ose të certifikatave, ajo marrëveshje do të pranohet si adekuate për qëllime të pranimit jashtë kufijve, përveç nëse ajo marrëveshje nuk do të jetë e vlefshme ose efektive sipas legjislacionit në fuqi.

KREU XIV

MBROJTJA E SISTEMEVE TË SHËRBIMEVE TË SHOQËRISË INFORMATIKE

Neni 63

Sistemet e shërbimeve të shoqërisë informatike

Mbrojtja e sistemeve të shërbimeve të shoqërisë informatike ka për qëllim që të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet organeve gjyqësore dhe autoriteteve tjera kompetente, përfshirë këtu policinë dhe shërbimet e specializuara për zbatim të ligjit nëpërmjet harmonizimit të dispozitave të Kodit Penal të Kosovës në pjesën e veprave penale kundër sistemeve informatike dhe transferit të të dhënave.

Neni 64

Qasja ilegale në sistemet informatike

1. Qasja me qëllim, pa të drejtë, në ndonjë pjesë ose në tërë sistemin informatik konsiderohet si veprë penale kur ajo bëhet:

1.1. kundër ndonjë pjese të një sistemi informatik që i nënshtrohet masave specifike të mbrojtjes;

1.2. me qëllim të shkaktimit të dëmit në personin fizik ose juridik;

1.3. me qëllim të përfitimit ekonomik.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni në veçanti zbatohen mbi përgjimin e të dhënave.

3. Sjelljet e qëllimshme si në vijim, pa të drejtë, do të konsiderohen si vepra penale:

3.1. pengimi ose ndërprerja serioze e funksionimit të një sistemi informatik duke hyrë, transmetuar, dëmtuar, fshirë, deformuar, ndryshuar, shtypur ose duke interpretuar të dhënat kompjuterike të pa qasshme;

3.2. fshirja, deformimi, ndryshimi, shtypja ose interpretimi i të dhënave kompjuterike të pa qasshme në një sistem informatik, kur bëhet me qëllim që t'i shkaktoj dëm personit fizik ose juridik.

4. Kur kryhet vepra penale nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kryesi dënohet një (1) deri në pesë (5) vite burgim.

5. Personi juridik është përgjegjës për kryerjen e veprës penale të parapare në paragrafin 1, 2 dhe 3 të këtij neni dhe dënohet sipas ligjit.

Neni 65
Nxitja, ndihma, shtyrja dhe tentimi

Nxitja me qëllim, për të ndihmuar ose shtyrë një shkelje që referohet në nenin 64 është e dënueshme.

Neni 66
Rrethanat rënduese

1. Veprat penale nga paragrafët 1., 2. dhe 3. të nenit 64 të këtij ligji dënohen jo më pak se pesë (5) vite burgim, kur ato kryhen nën këto rrethana:

1.1. kur vepra penale është bërë përbrenda kornizës së një organizate kriminale siç përkufizohet në Dokumentin “Veprimi i përbashkët i Bashkimit Evropian 98/733/JHA” të 21 dhjetorit 1998 që e bën vepër penale pjesëmarrjen në një organizatë kriminale në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, përveç lartësisë së dënimit që i referohemi këtu;

1.2. vepra penale ka shkaktuar ose ka rezultuar në, humbje të konsiderueshme ekonomike të drejtpërdrejt ose të tërthortë, dëmtim fizik të personit fizik ose dëmtim të konsiderueshëm në pjesë të infrastrukturës kritike të Kosovës;

1.3. vepra penale ka rezultuar me përfitime të konsiderueshme.

2. Veprat penale që referohen në paragrafët 1., 2. dhe 3. të nenit 64 të këtij ligji dënohen me burgim më të lartë se ai i paraparë në paragrafin 4. të nenit 64 të këtij ligji, kur kryesi është dënuar për shkelje të tilla me aktgjykim të formës së prerë, nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.

Neni 67
Shkëmbimi i informatave

Me qëllim të shkëmbimit të informatave në lidhje me shkeljet që referohen në nenin 64 dhe 66 të këtij ligji dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi do të themelohet pika e kontaktit siç parashihet në Ligjin për parandalimin dhe luftimin e Krimit Kibernetik.

KREU XV
DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 68
Parimet e përgjithshme

Çështjet që shprehimisht nuk janë të rregulluara me këtë ligj do të rregullohen në pajtim me parimet e përgjithshme në të cilat ky ligj është bazuar.

Neni 69
Zbatimi i ligjit

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria dhe Autoriteti, në afatin prej dymbëdhjetë (12) muajsh nxjerrin akte nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 70
Dispozita shfuqizuese

Ky ligj shfuqizon Ligjin nr.2005/02–L23 për shërbimet e Shoqërisë Informatike.

Neni 71
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-094
15 mars 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI